



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 138/6 Prot

Tiranë më 10 .03 . 2015

V E N D I M

Nr 13 Datë 10 / 03 / 2015

**Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil ,
në institucionin e Komitetit Shtetëror për Kultet**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", (i ndryshuar), si dhe neneve 80-104 të ligjit nr.8485, datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Mbikëqyrjes, në lidhje me mbikëqyrjen e zhvilluar në institucionin e Komitetit Shtetëror për Kultet,

VËREJ SE:

Në zbatim të vendimit nr. 5, datë 28.01.2015 "Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në institucionin e Komitetit Shtetëror për Kultet", ka filluar kryesisht mbikëqyrja tematike në institucionin e Komitetit Shtetëror për Kultet.

Objekti i mbikëqyrjes është kufizuar në disa institute të ligjit, ndër të cilat deklarimi i statusit të punësimit për punonjësit e institucionit që kanë qenë në marrëdhënie pune në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit për nëpunësin civil, si detyrim i parashikuar në mënyrë të shprehur në dispozitat tranzitore të ligjit; respektimi i kërkesave të përgjithëshme për pranimin në shërbimin civil; përshkrimi i punës për pozicionet që janë pjesë e shërbimit civil sipas formës dhe procedurës së kërkuar nga ligji.

Mbikëqyrja është zhvilluar në përputhje me Programin e Mbikëqyrjes me nr. 138/2 prot., datë 28.01.2015, i cili është miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe i është njoftuar institucionit me shkresën nr. 138/1 prot., datë 28.01.2015 "Njoftim për fillimin e mbikëqyrjes". Në përfundim të këtij procesi, grupi i mbikëqyrjes ka hartuar projekt – raportin, dërguar për njohje subjektit të kontrolluar, me shkresën nr. 138/3, datë 27.02.2015 "Dërgohet projekt raporti", duke i lënë 3 ditë kohë për të paraqitur observacionet në lidhje me materialin. Pas kësaj, projekt raporti është kthyer i nënshkruar nga titullari i institucionit dhe nëpunësi përgjegjës për administrimin e burimeve njerëzore në institucion, me shkresën e regjistruar pranë Komisionerit, me nr. 138/5, datë 04.03.2015 "Dërgohet projekt raporti".

Nga përmbajtja e shkresës përcjellëse, rezulton se subjekti i mbikëqyrur është shprehur dakort me konkluzionet e arritura nga grupi i punës dhe nuk ka bërë asnjë vërejtje në lidhje me materialin.

Sa më sipër, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, çmon se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikën e evidentuar.

Në këto rrethana, Komisioneri vijoi me shqyrtimin e përmbajtjes së raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës dhe në përfundim të këtij procesi, vlerëson se duhet të miratojë përmbajtjen e tij.

Për këto arsye:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 *"Për nëpunësin civil"*,

V E N D O S A:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil, në institucionin e Komitetit Shtetëror për Kultet, që do të jetë pjesë e këtij vendimi.
2. Me miratimin e strukturës së re të institucionit, të dërgohet një kopje pranë Komisionerit, me qëllim që të mundësohet verifikimi i rekomandimeve të parashikuara në raportin e mbikëqyrjes.
3. Të plotësohet dosja e personelit me dokumentat që vërtetojnë gjendjen gjyqësore dhe gjendjen shëndetësore, sipas rekomandimit në raportin e mbikëqyrjes, brenda 15 ditëve nga dalja e këtij vendimi dhe të njoftohet me shkrim Komisioneri për realizimin e detyrës.
4. Për këtë vendim të njoftohet Komiteti Shtetëror për Kultet dhe Departamenti i Administratës Publike, duke i dërguar një kopje të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe njëkohësisht, të informohet Komisioni i Ligjeve në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA